

UDHËZIM
Nr.16, datë 7.8.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 30.1.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 22.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

I: Pika 2.5 “Taksa e importimit të automjeteve të përdorura” e udhëzimit nr.1, datë 30.1.2006 “Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” riformulohet si më poshtë:

“2.5 Taksa e importimit të automjeteve të përdorura

“Agjent tatimor për vjeljen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura janë degët doganore në pikat e kalimit të kufirit. Kjo taksë paguhet nga importuesi i automjetit në momentin e zhdoganimit të tij. Degët doganore bëjnë llogaritjen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura sipas llojeve të mjeteve:

2.5.1 Për autoveturat, llogaritja e taksës bëhet sipas pikës 5.3 të nenit 2 të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 22.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Llogaritja e taksës bëhet sipas formulës:

Taksa fikse x Cilindrata e motorit x Koeficienti i viteve të përdorimit.

Taksa fikse për autoveturat me naftë është 25 mijë lekë, ndërsa për autoveturat me benzinë 20 mijë lekë.

Cilindrata e motorit është volumi i dhomës së djegies së motorit e shprehur në centimetër kub dhe jepet në certifikatën shoqëruese të mjetit.

Vite përdorimi quhen diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në doganën shqiptare dhe vitit të prodhimit.

Shembull 1: Llogaritja e taksës për një autoveturë tip benz 190 i prodhuar në vitin 2002 me naftë dhe i importuar në vitin 2007, bëhet si më poshtë:

- Koeficienti sipas ligjit është 0.0029;
- Cilindrata e motorit është 1930 centimetër kub;
- Taksa fikse 25 mijë lekë;
- $1930 \times 25000 \times 0.0029 = 139.925$ lekë.

Shembull 2: Llogaritja e taksës për një autoveturë, e cila në momentin e zhdoganimit ka mbi 10 vjet prodhimi, për të njëjtin tip autoveture si në shembullin e mësipërm, bëhet si më poshtë:

- $1930 \times 25000 \times 0.0048 = 231.600$ lekë.

Në çdo rast, llogaritja e taksës së importimit të autoveturave të përdorura, do të bëhet sipas formulës së pikës 5.3 të ligjit. Në qoftë se nga llogaritjet sipas pikës 5.3 të ligjit, taksa e importimit të autoveturave të përdorura rezulton më e vogël se nivelet e parashikuara në pikat “5.1.a” dhe “5.2.a” të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007, taksa do të mbahet sipas këtyre pikave.

2.5.2 Për mjetet e tjera të transportit, llogaritja e taksës është e diferencuar sipas vitit të prodhimit, për 10 ose më shumë vite prodhimi dhe për më pak se 10 vite prodhimi. Taksa është fikse sipas llojit të mjetit e përcaktuar në pikën 5 të nenit 5 të ligjit.

Degët e doganës të gjitha arkëtimet nga taksat i evidentojnë në regjistër, sipas formularit nr.6 bashkëngjitur udhëzimit nr.1, datë 30.1.2006.”

II: Në pikën 2.4 “Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja” në krye të saj shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Autoveturat e huaja, të përfshira në pikën 1 të lidhjes 4 të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit për 60 ditë qëndrimi në vit në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe paguajnë vetëm 1 euro në çastin e daljes. Për çdo ditë qëndrimi mbi këtë periudhë, taksa e qarkullimit llogaritet sipas lidhjes nr.4 të ligjit të cituar më lart.

Shembull:

Një autoveturë e huaj që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 15 korrik 2007 dhe do të dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë në datën 15 gusht 2007 do të paguajë:

a) për periudhën deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007:

21 ditë x 1 euro/ditë = 21 euro

b) për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007, deri në datën 15 gusht 2007 (pra brenda 60 ditëve) do të paguajë shumën prej 1 euro.

c) pagesa gjithsej e taksës 21 euro + 1 euro = 22 eurosh.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare, dhe hyn në fuqi në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 22.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode